



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 6, 8 dhe 14 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 8 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës, nenin 12 të Rregullores (ZKA) 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës (shpallur në Gazetën Zyrtare më 14.09.2021); si Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm Nr. 1841 të datës 16.09.2021 për plotësimin e vendeve të lira të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM **për plotësimin e vendeve të lira të punës**

1. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit financiar dhe pajtueshmërisë – nëntë (9) ekzekutues;

Numri i referencës: DDAFP/ZKA/08-09/21
Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet
Grada: ZKA-A3
Raporton tek: Ndhmës Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron që auditimet kryhen sipas planit vjetor të auditimit në përputhje me SNISA-të, rregulloret e brendshme dhe ligjin e ZKA-së;
- Përgjegjës për zhvillimin e planeve individuale dhe programeve të auditimit;
- Përgjegjës për kryerjen e vlerësimeve të nevojave për burime njerëzore dhe materiale si dhe shpërndarjen e tyre racionale në përmbushjen e aktiviteteve;
- Siguron se afatet kohore planifikohen në detaje në kryerjen e aktiviteteve të planifikuara;
- Përgjegjës në kryerjen e rishikimeve, vlerësimeve dhe ekzaminimeve të pasqyrave vjetore dhe periodike financiare, në përcaktimin nëse ato janë të sakta dhe paraqesin gjendjen e drejtë dhe të vërtetë financiare të subjektit të audituar;
- Përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve, nëse llogaritë paraqesin llogari reale dhe transaksionet janë në pajtim me ligjin dhe rregullat financiare;
- Përgjegjës për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, testimin nëse janë të dizajnuar si duhet, të përshtatshme dhe nëse operojnë në mënyrë efektive;
- Përgjegjës për hartimin e memorandumeve dhe raporteve të auditimit, duke propozuar opinionet e auditimit të Auditorit të Përgjithshëm nëse pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe nëse shpalosjet janë të mjaftueshme;
- Sigurohet se të gjitha standardet e cilësisë të përcaktuara në Manualin e Cilësisë zbatohen të gjitha fazat e auditimit;
- Sigurohet se planet e veprimit dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara monitorohen në mënyrë sistematike;

- Siguron pjesëmarrje aktive në hartimin e Raportit Vjetor të Auditimit, duke ofruar kontributet e kërkuara nga fusha përkatëse;
- Siguron zbatimin e të gjitha rregulloreve, udhëzimeve, politikave dhe procedurave të brendshme siç përcaktohen nga ZKA;
- Raporton tek Ndhmës Auditorit të Përgjithshëm në baza të rregullta për mbarëvajtjen dhe sfidat e mundshme në procesin e auditimit dhe zbatimin e planeve operative; dhe
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Ndhmës Auditori i Përgjithshëm.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

2. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës – një (1) ekzekutues;

Numri i referencës: DDAP/ZKA/09-09/21

Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet

Grada: ZKA-A3

Raporton tek: Ndhmës Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron që auditimet kryhen sipas planit vjetor të auditimit në përputhje me SNISA-të, Ligjin dhe rregulloret e brendshme të ZKA-së, legjislacionin në fuqi, duke ekzaminuar një aspekt të veçantë të aktiviteteve, në tërësi ose të pjesshme, të ndonjë institucioni, programi, fushëveprimi apo aktiviteti për të vlerësuar:
 - Ekuilibrimin e aktiviteteve në përputhje me parimet, praktikat administrative, ligjore dhe politikat menaxheriale;
 - Efikasitetin në përdorimin e burimeve financiare, njerëzore dhe tjera, përfshirë shqyrtimin e sistemeve të informacionit, aranzhimeve për matjen dhe monitorimin e performancës si dhe të procedurave që entitetet e audituara ndjekin për të evituar mangësitë e identifikuara; dhe
 - Efektivitetin e aktiviteteve në raport me arritjen e objektivave të entitetit të audituar dhe ndikimin faktik të aktiviteteve krahasuar me ndikimin e synuar.
- Kujdeset për kryerjen e auditimeve të sistemeve të Teknologjisë Informativesipas objektivave të përcaktuara;
- Ndhmon Departamentin e metodologjisë në hartimin e doracakëve të auditimit të Performancës;
- Harton memo-parastudimore, dizajn matricat dhe raporte të auditimit;
- Monitoron në mënyrë sistematike planet e veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara;
- Merr pjesë aktive në hartimin e Raportit Vjetor të Auditimit, duke i ofruar kontributet e kërkuara nga fushat përkatëse;
- Bën zbatimin e të gjitha rregullorev, udhëzimeve, politikave dhe procedurave të brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- Realizon raportim në baza të rregullta te Auditori i Përgjithshëm për progresin dhe sfidat eventuale në procesin e auditimit dhe realizimin e planeve operative; dhe
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Ndhmës Auditori i Përgjithshëm.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (certifikim për auditor ose auditor i certifikuar i sektorit publik);
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit të Prokurimit – një (1) ekzekutues;

Numri i referencës: DDAPR/ZKA/10-09/21
Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet
Grada: ZKA-A3
Raporton tek: Ndihmës Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime në pajtim me Planin Vjetor të Auditimit, në përputhje me SNISA, aktet e brendshme të ZKA-së, doracakët e auditimit dhe legjislacionin në fuqi, duke ekzaminuar një aspekt të veçantë të aktiviteteve, në tërësi ose të pjesshme, të ndonjë institucioni, programi, fushëveprimi apo aktiviteti për të vlerësuar:
 - Ekonomicitetin e aktiviteteve në përputhje me parimet, praktikat administrative, ligjore dhe politikat menaxheriale;
 - Efikasitetin në përdorimin e burimeve financiare, njerëzore dhe tjera, aranzhimeve për matjen dhe monitorimin e performancës si dhe të procedurave që entitetet e audituara ndjekin për të evituar mangësitë e identifikuara; dhe
 - Efektivitetin e aktiviteteve në raport me arritjen e objektivave të entitetit të audituar dhe ndikimin faktik të aktiviteteve krahasuar me ndikimin e synuar.
- Kryen auditime të projekteve të një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjesshme të ndonjë institucioni, programi apo aktiviteti;
- Kryen auditime të projekteve/fondeve të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe sipas kërkesave edhe nga buxheti i ndonjë shteti apo donatori për të vlerësuar shfrytëzimin e fondeve në pajtim me kushtet e përcaktuara;
- Kryen auditime të prokurimit në projektet e caktuara, të huave, kredive dhe detyrimeve të garantuara nga entitetet e sektorit publik;
- Ndihmon Departamentin e metodologjisë në hartimin e doracakëve të auditimit të Prokurimit;
- Harton memo-parastudimore, dizajn matricat dhe raporte të auditimit;
- Kryen studimin kryesor bazuar në planin auditues të aprovuar;
- Monitoron në mënyrë sistematike planet e veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara;
- Ofron mbështetje në hartimin e RVA, dhe Raportin Vjetor të Performancës;
- Zbaton të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- Raporton në baza të rregullta për progresin dhe sfidat eventuale në procesin e auditimit dhe realizimin e planeve operative; dhe
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (certifikim për auditor ose auditor i certifikuar i sektorit publik);
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

4. Pozita: Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – një (1) ekzekutues;

Numri i referencës: DDATI/ZKA/11-09/21
Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet
Grada: ZKA-A3
Raporton tek: Ndhmës Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime të TI-së sipas Planit Vjetor të Auditimit, në përputhje me SNISA, aktet e brendshme të ZKA-së dhe legjislacionin në fuqi, duke ekzaminuar një aspekt të veçantë të aktiviteteve, në tërësi ose të pjesshme, të ndonjë institucioni, programi, fushëveprimi apo aktiviteti në mënyrë që të vlerësojë se burimet e TI-së lejojnë të arrihen qëllimet e organizatës efektivisht dhe përdorimin në mënyrë efikase të këtyre burimeve;
- Kryen rishikimin e kontrolleve të sistemeve të TI-së, vlerësimin e proceseve, vlerësimin e performancës të një sistemi dhe sigurisë së tij, zhvillimet e sistemeve dhe të procedurave, etj;
- Ndhmon Departamentin e metodologjisë në hartimin e Doracakëve të Auditimit të TI-së;
- Harton memo-parastudimore, dizajn matricat dhe raporte të auditimit;
- Kryen studimin kryesor bazuar në planin auditues të aprovuar;
- Monitoron në mënyrë sistematike planet e veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet e audituara;
- Ofron mbështetje në hartimin e RVA, dhe Raportin Vjetor të Performancës;
- Zbatoj të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- Raporton në baza të rregullta për progresin dhe sfidat eventuale në procesin e auditimit dhe realizimin e planeve operative; dhe
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e TI-së;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Preferohet certifikimi për auditor nga fusha e TI-së;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

- 5. Pozita: Drejtor i Departamentit për Metodologji në Auditim – një (1) ekzekutues;**
Numri i referencës: DDMA/ZKA/12-09/21
Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet
Grada: ZKA-A3
Raporton tek: Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përditëson metodologjinë e brendshme në pajtim me SNISA-t dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- Harton dhe përditëson Doracakët e Auditimit dhe udhëzuesit për Kontrollin e Cilësisë në Auditim si dhe letrat të punës;
- Siguron përkrahjen e vazhdueshme dhe efektive për ekipet e auditimit përmes metodave më të zhvilluara të auditimit;
- Zhvillon dhe realizon programet efektive të trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive teknike për auditorët;
- Ndhomon në implementimin e projekteve përkrahëse që ndërlidhen me menaxhimin e cilësisë;
- Në bashkëpunim me njësitë tjera i propozon Auditorit të Përgjithshëm për miratim dokumentet strategjike dhe planet përkatëse;
- Ofron asistencë në aplikimin e softuerit SITA, IDEA dhe aplikacioneve të tjera të auditimit;
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

- 6. Pozita: Drejtor i Departamentit për Sigurimin e Cilësisë në auditim – një (1) ekzekutues;**

Numri i referencës: DDSCA/ZKA/13-09/21
Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet
Grada: ZKA-A3
Raporton tek: Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë Planin Vjetor dhe përcakton fushat e rishikimit të cilësisë për auditimin e entiteteve të caktuara;
- Bënë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe ofron siguri të arsyeshme se auditimet janë kryer në përputhje me SNISA-t;
- Përgatitë dhe plotëson formularët e përcaktuar me Udhëzuesin për Kontrollin e Cilësisë në Auditim dhe nxjerrë konkluzionet për rezultatet e rishikimit dhe të paraqet komente për nivelin e cilësisë, duke ofruar edhe rekomandimet për përmirësime;
- Rishikon dhe analizon gjetjet e auditimit dhe siguron se ato janë të mbështetura me dëshmitë e duhura;
- Në raste të caktuara, rishikon dhe analizon mostrat e përzgjedhura nëse ato kanë qenë reprezentative, të mjaftueshme, të rëndësishme dhe janë trajtuar me kujdesin e duhur;
- Rishikon dhe analizon opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) dhe jep këshilla për përshtatshmërinë e opinionëve me gjetjet e raportit, kur është e nevojshme;

- Zbaton kornizën e menaxhimit të cilësisë dhe bënë rishikimin e vazhdueshëm të efektivitetit;
- Harton raporte periodike për gjetjet nga procesi i rishikimit të cilësisë;
- Ofron këshilla për stafin auditues në fushën e cilësisë;
- Informon dhe ndihmon menaxhmentin e lartë të ZKA-së për të gjitha çështjet me ndikim domethënës në procesin e auditimit, që kanë të bëjnë me kontrollin dhe sigurimin e cilësisë; dhe
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

7. Pozita: Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza – një (1) ekzekutues;

Numri i referencës: DDPSRA/ZKA/14-09/21

Kohëzgjatja e emërimit: Tre (3) vjet

Grada: ZKA-A3

Raporton tek: Auditori i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Nën udhëzimet e drejtpërdrejta të Auditorit të Përgjithshëm dhe të kabinetit të tij, zhvillon strategjinë gjithëpërfshirëse të ZKA-së;
- Është përgjegjës për zhvillimin e planit vjetor dhe strategjik të ZKA-së dhe përgatitjen e planit veprues për zbatimin e strategjisë dhe i raporton Auditorit të Përgjithshëm për progresin e arritur;
- Zhvillon, zbaton dhe raporton për treguesit e performancës së ZKA-së dhe kundrejt objektivave të planifikuara;
- Është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve për treguesit e performancës dhe propozimin e masave për realizimin e strategjisë dhe konvertimin e tyre në objektiva operacionale;
- Në bashkëpunim me njësitë tjera organizative i propozon Auditorit të Përgjithshëm plotësim-ndryshimin e dokumenteve strategjike dhe planeve tjera të punës në ZKA;
- Jep këshilla për Auditorin e Përgjithshëm, që ndërlidhen me çështjet strategjike, si dhe ndihmon njësitë tjera organizative të ZKA-së në interpretimin e objektivave individuale strategjike;
- Në bashkëpunim me departamentet tjera, deri më 31 mars të vitit aktual përgatit raportin vjetor të performancës së ZKA-së për vitin paraprak;
- Bën analiza të Ligjit për ndarjet buxhetore dhe Ligjit për rishikim të buxhetit, me fokus të veçantë në klasifikimin e drejtë të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike, dhe të njëjtën ia dorëzon ekipit të RVA-së;
- Nga Ministria e Financave, respektivisht nga Thesari mbledhë të gjitha të dhënat e nevojshme për ekipet e auditimit, me theks të veçantë raportet periodike mbi buxhetin, të hyrat, shpenzimet dhe raportet tjera, si dhe kryen analizën dhe selektimin e të dhënave sipas nevojave të auditimit;

- Në koordinim me përgjegjësin kryesor për hartimin e RVA, ndihmon ekipin e auditimit me analiza të ndryshme. Në veçanti, mbledhë, konsolidon dhe përpunon kontributet e ekipeve përmes Pyetësorëve të auditimit për hartimin e RVA, dhe ekipit të RVA-së i dorëzon një raport përmbledhës mbi gjetjet dhe rekomandimet e dala nga Pyetësorët;
- Ndihmon përgjegjësin kryesor për hartimin e RVA-së dhe informatave tjera të nevojshme;
- Mbledhë dhe bën analizën e të dhënave statistikore të ZKA-së; dhe
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

Procedura e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë punonjësit brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2021 për Pranim dhe Karrierë, Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës, si dhe Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2021 për Organizim të brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës.

Konkursi është i hapur 5 ditë pune pas ditës së publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZKA-së dhe në tabelen e shpalljeve zyrtare, duke filluar nga data **16.09.2021**, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **23.09.2021, ora 16.00**.

Formularët zyrtar për konkurrim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga në faqja e internetit e ZKA-së në adresën <http://www.zka-rks.org/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005;

Aplikacionit duhet t’i bashkangjiten:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim.
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen.

Shënim:

Dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit të brendshëm e që janë pjesë e dosjes personale, mund të sigurohen në çdo kohë nga DBBNJ, sipas kërkesës së kandidatit.